



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 56 prot.

Kamëz, më 19.04.2022

V E N D I M

Nr. 49 .Datë 19/04 2022

MBI

“ MIRATIMIN E NJË SHTESE NË LISTËN E VENDIMIT NR.97 DATË10.11.2021 SË SUBJEKTEVE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA GRANTET PËR RINDËRTIMIN E SHTËPIVE INDIVIDUALE, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, VLERËSUAR NGA AKT EKSPERTIZAT E THELLUARA TË INSTITUTIT TË NDËRTIMIT “PËR SHEMBJE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.04.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.46 Datë 15.04.2022 në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”, aktin nr. 09 datë 16.12.2019, “ Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore ”, Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “ Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, të ndryshuar, Vendim Nr. 904, datë 24.12.2019 “ Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe për zgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit ”, Vendim Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar “ Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”, Vendim Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”, Vendim Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Vendim Nr.22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz “ Për miratimin e manualit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit ” Urdhërit nr. 479 datë 22.09.2021 “Për ngritjen e komisionit të pocaçëm të rindërtimit për aplikuesit në Njësinë Administrative Paskuqan për dosjet e administruara sipas urdherit nr.456 datë 10.09.2021 “, **Këshilli Bashkiak Kamëz ”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin e një shtese në listën e subjekteve përfitues të Vendimit Nr.97 Datë10.11.2021, të cilët plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar nga grantet e rindërtimit e shtëpive individuale sipas përbërjes familjare mbështetur ne V.K.M Nr.5, datë 06.01.2020 i ndryshuar pika V, tabela A.



REPUBLIKA E SHQIPËRI
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Përbërja familjare	Sipërfaqja në metër katrorë (m2)	Masa e grantit
Deri në 2 anëtarë	60 m2 deri në 70 m2	Preventivi i projektit model
3 deri në 4 anëtarë	70 m2 deri në 80 m2	Preventivi i projektit model
5 e më shumë anëtarë	Jo më pak se 90 m2	Preventivi i projektit model

2. Lista e subjekteve shtesë përfitues e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, paraqitet në aneksin bashkëlidhur dhe është pjesë e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga **Prefekti i Qarkut Tiranë**.

Kryetar Këshilli
HYSEN KOLDASHI

